



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Kabineti i Ministrit - Kancelarija Ministra - Cabinet of the Minister

Nr. 11 /2026
Datë: 29/012026

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, nr. 7, 01 mars 2019), në përputhje me nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 3 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.15.4) dhe nenin 4 të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, si dhe në përputhje me nenin 7 dhe 8 të Rregullores nr. 01/2019 Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Ushtruesi i Detyrës së Ministrit të Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për delegimin e autorizimeve për zyrtar autorizues për menaxhimin e buxhetit, shpenzimeve dhe pasurisë

1. Ministria e Drejtësisë – Anita Kalanderi, Sekretare e Përgjithshme.
2. Agjencitë Ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, si në vijim:
 - 2.1. Shërbimi Korrektues i Kosovës – Ismail Dibrani, Drejtor i Përgjithshëm;
 - 2.2. Shërbimi Sprovues i Kosovës – Arsim Tahiri, Drejtor i Përgjithshëm;
 - 2.3. Instituti i Mjekësisë Ligjore – Agron Thaçi, Ushtrues i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm;
 - 2.4. Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar – Alban Sutaj, Ushtrues i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm;
 - 2.5. Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë – Muamer Bikliqi, zv. Kryeinspektor;
 - 2.6. Avokatura Shtetërore – Arsim Zuka, zv. Avokat i Përgjithshëm Shtetëror
 - 2.7. Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, z. Faton Jashari, Ushtrues i Detyrës së Drejtorit Ekzekutiv.
3. Zyrtarët e përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij vendimi tek të cilët janë deleguar autorizimet, janë të obliguar që të veprojnë në harmoni me Ligjin përkatës mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin përkatës të Buxhetit, Ligjin përkatës të Prokurimit dhe dispozitat tjera përkatëse dhe të delegojnë autorizimet për menaxhimin financiar dhe kontrollin zyrtarëve përkatës të tyre.

4. Zyrtarët autorizues, të cilëve ju janë deleguar autorizimet, përveç autorizimeve sipas paragrafit 3, ju delegohen të gjitha autorizimet për menaxhimin e pasurisë jo financiare sipas Rregullores nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare, neni 4, (pika 1, 2, 3 dhe 4), që të menaxhojnë pasurinë jo financiare për departamentet/divizionet/sectorët/programet të cilat i udhëheqin, në të gjitha aspektet, duke filluar nga autorizimi, pranimi, dhënia në shfrytëzim, kujdesi, mbajtja e evidencës, regjistrimi, vlerësimi pas amortizimit ekonomik apo shlyerja-përveç tjetërsimi. Të gjitha veprimet, duhet të merren sipas ligjeve dhe rregulloreve të cilat janë në fuqi
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Blerim SALLAHU
Ushtrues i Detyrës së Ministrit të Drejtësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Të lartpërmendurave;
- Kabinetit të Ushtruesit të Detyrës së Ministrit të Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Departamentit për Shërbime të Përgjithshme;
- Departamentit për Buxhet dhe Financa;
- Departamentit të Prokurimit;
- Arkivit të MD-së.